



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER DHURATA VARDHAMI
ADRESA RR. SAMI FRASHERI
TEL: 0674110083

MARRËVESHJE SIGURUESE

(MARRËVESHJE E BARRËS SIGURUESE KUOTA/AKSIONE)

Nr. repertori: 1654

Nr. koleksioni: 396

Tirane më 10/12/2021



Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

*Akti noterial përbëhet nga 2 fletë



A2021054130042581676

NOTOR
TIRANA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBETARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANE
NR. 1654 REP.
NR. 396 KOL.

REPUBLIC OF ALBANIA
NATIONAL CHAMBER OF NOTARY
TIRANA LOCAL BRANCH
NR. 1654 REP
NR. 396 KOL

MARRËVESHJE SIGURUESE
MBI KUOTA

SECURING CHARGE AGREEMENT

ndërmjet

OVER SHARES

between

DUFERCO ENERGIA S.P.A.
si Barrëdhënës

DUFERCO ENERGIA S.P.A.
as Chargor

dhe

and

OTP BANK ALBANIA SHA
si Barrëmarrës

OTP BANK ALBANIA SHA
as Chargee

Sot, me 10/12/2021 ne Tirane, perpara meje noteres Dhurota Vexho u paraqiten personalisht palet e meposhtme, te cilet deklarojne perpara meje se me vullnetin e tyre te lire lidhin kete Marreveshje Siguruese si me poshte:

On this day, on 10/12/2021, in Tirana, in front of me the Public Notary Dhurota Vexho were personally presented the following parties who in their free will sign this Securing Charge agreement as per below

Kjo Marrëveshje Siguruese (referuar në vijim si "Marrëveshja" ose "Marrëveshja e Barres Siguruese" lidhet në Tiranë midis:

This Securing Charge Agreement (hereinafter as the "Agreement" or the "Securing Charge Agreement" is made in Tirana by and between:

• **DUFERCO ENERGIA S.P.A.**, shoqëri aksionare, e regjistruar dhe e cëspron në bazë të ligjeve të Republikës së Italisë, me numër regjistrimi 03544070174, me seli dhe adresë: Via Imperiale Paolo 4 (GE)CAP 16126, Gjenova,Itali, perfaqesuar ketu ne baze te Vendimit te Asamblese se Pergjithshme Nr. 05 date 09/12/2021 nga Administratori i saj / Perfaqesuesi Ligjor **Z. Simone Rabaioli**, i biri i Pietro, lindur ne Brescia (Itali), me 14.04.1970, banues/e ne adresen Rruga "Cappelletti" Nr. 5, Quinzano d'Oglio (BS - Italia), mbajtes/e i/e Pasaportes Nr. YA4190942 leshuar ne daten 26.03.2013, madhor/e, me zotesi te plote juridike per te vepruar, nga ana tjetere, (I quajtur ne vijim si "" ose "Barrëdhënësi";

• **DUFERCO ENERGIA S.P.A.**, a joint stock company registered and validly existing under the laws of Republic of Italy, under company registration number 03544070174, with its seat and address at: Via Imperiale Paolo 4 (GE)CAP 16126 Genova, Italy represented herein based on the decision of the General Assembly, no. 05 dated 09/12/2021, by **Mr. Simone Rabaioli**, Italian citizen, son of Pietro, born in Brescia (Italy), on 14/04/1970, resident at the address, via Cappelletti 5, 25017 Quinzano d'Oglio (BS - Italy), holder of the Passport YA4190942 issued as of 26/03/2013, major, with full legal capacity to act, on the other side hereinafter called (or the "Chargor");

dhe

and

• **BANKA OTP ALBANIA SHA** një shoqëri e organizuar si një shoqëri aksionare sipas ligjeve të Shqipërisë, me numër regjistrimi K41424801U, me adresë në: Blv.Deshmoret e Kombit', Twin Towers Kulla 1, Kt.10,Tirane,

• **OTP BANK ALBANIA SHA**, a company organised as a joint stock company under the laws of Albania, with registration number K41424801U, with legal address in: Blv."Deshmoret e Kombit", Twin Towers

përfaqësuar në këtë Marrëveshje nga Bankier i Sektorit të Klienteve Nderkombetare dhe Finances të Strukturuar Zj. Pojana Shabaku, e bija e Prenges, lindur ne Tirane, me 23.05.1988, banuese ne Tirane, mbajtese e Leternjoftimit Nr. 034433289, dhe me nr. personal I85523069R, madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar dhe nga Menaxhere e Departamentit te SME, Qirase Financiare dhe Klienteve nderkombetare Zj. Sabina Gjinali, e bija e Ermirit, lindur ne Tirane, me 07.07.1975, banuese ne Tirane, mbajtese e leternjoftimit Nr. BE1615987, me nr. personal H55707142V, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar (me tej referuar si "Banka" ose si "Barremarresi" ose si "OBA");

Secili prej subjekteve ligjore të renditura më sipër, quajtur veçmas si "Palë" dhe bashkërisht si "Palët",

HYRJE:

DUKE PATUR PARASYSH SE:

(A) Në mbështetje të Kontrates Per Kredi Bankare Afatgjate Nr. 1650 Rep dhe Nr. 392 Kol — date 10.12.2021 te noterit Blenda Vardolani lidhur midis Barremarresit (në cilësinë e Kredidhenesit) dhe Shoqeria Tregtare 'DUFERCO POBREG' SH.P.K. me seli ne adresen Rruga "Sami Frasheri", Pallati Perxholla nr.1, Shkalla 1, Kati 2, Tirane, Shqiperi, regjistruar si person juridik shqiptar ne Qendren Kombetare te Biznesit me NIPT me Nr. Identifikimi M11518006H ne daten 18/03/2021 dhe qe ligjerisht perfaqesohet nga Administratori i saj **Z. Simone Rabaioli**, i biri i Pietro, lindur ne Brescia (Itali), me 14.04.1970, banues/e ne adresen Rruga "Cappelletti" Nr. 5, Quinzano d'Oglio (BS – Italia), mbajtes/e i/e Pasaportes Nr. YA4190942 leshuar ne daten 26.03.2013 madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, (ne cilesine e Kredimarrësit), Banka ne cilesine e kredidhenesit ka vene ne dispozicion te Kredimarrësit nje kredi ne shumen prej ekulivalenti ne LEK i 10,000,000 EUR (dhjete milione euro)

Kulla 1, Kt.10, Tirana, Albania, represented hereby by International Clients Relationship Manager International Desk & Structured Finance, Mrs. Pojana Shabaku, Albanian citizen, daughter of Preng, born in Tirana, on 23.05.1988, resident in Tirana, holder of the Identification Card with No 034433289, with Personal No. I85523069R adult having full juridical capacity to act and by the Manager of the Department of SME, Leasing and Internatioanl Clients, Ms. Sabina Gjinali, daughter of Ermir, born in Tirane, on 07.07.1975, resident in Tirane, owning identification card with no. BE1615987, and personal number H55707142V, adult having full juridical capacity to act (hereinafter referred to as "The bank", "OBA" or the "Chargee",

Each one of the legal entities listed above individually referred to as a "Party" and collectively as "Parties",

RECITALS:

WHEREAS:

(A) Pursuant to the Long-Term Bank Loan Agreement no. 1650 Rep and NR 392 Kol — date 10.12.2021 of the notary Blenda Vardolani concluded between the Chargee (as Lender) and the Company "DUFERCO POBREG" SH.P.K. with registered headquarters in the address Rruga "Sami Frasheri", Pallati Perxholla nr.1, Shkalla 1, Kati 2, Tirane,, Albania,, registered as an Albanian legal entity in the National Registration Centre with NIUS M11518006H on 18/03/2021, and legally represented by its Legal representative Administrator **Mr. Simone Rabaioli**, Italian citizen, son of Pietro, born in Brescia (Italy), on 14/04/1970, resident at the address, via Cappelletti 5, 25017 Quinzano d'Oglio (BS – Italy), holder of the Passport YA4190942 issued as of 26/03/2013, (as Borrower) , the Bank (as Lender) have made available to the Borrower a loan at the amount of the equivalent in ALL of 10,000,000 EUR (ten million euro),

(referred below as "Facility Agreement")

P-57
2
M

A

(me tej se bashku do te referohet si "Marrëveshja e Kredisë")

(B) Eshte kusht paraprak i Marreveshjes se Huase qe te nenshkruset kjo Marreveshje me qellim krijimin e nje barre ne formen e Barres Siguruese (sipas perkufizimit me poshte) mbi Kolateralin (sipas perkufizimit me poshte) nga DUFERCO ENERGIA S.P.A, ne cilesine e Barredhenesit, ne favor te Barremarresit, i cili njekohesisht eshte edhe Huadhënësi;

(C) Me qellim sigurimin e detyrimeve aktuale dhe te ardhshme qe Kredimarresi ka ose mund te kene ndaj Huadhënesit (i cili këtu ne kete Marreveshje eshte ne cilësinë e Barremarresit) sipas Marreveshjes se Huase te cituar me lart, Barredhenesi bie dakort qe, nder te tjera, te hyje ne kete Marreveshje me qellim sigurimin e permbushjes se Detyrimeve te Siguruara (sipas perkufizimit me poshte) te Kredimarresit kundrejt Huadhënesit (këtu Barremarres) duke barresuar dhe regjistruar nje barre siguruese mbi kuotat e zoteruara aktualisht ose qe mund te zoterohen ne te ardhmen tek Kredimarresi 'DUFERCO POBREG'SH.P.K me NUIS M11518006H, te cilet perfaqesojne 100%(njeqind perqind) te kapitalit te kuotave te Kredimarresit 'DUFERCO POBREG'SH.P.K me NUIS M11518006H, ose cdo vlere apo perqindje qe mund te perfaqesojne ne te ardhmen.

BAZUAR NE SA ME SIPER, Palet, me qellimin per tu angazhuar ligjerish, bien dakord si më poshtë:

1.PËRKUFIZIMET

1.1. Përkufizimet

Termat e përdorur kudo në këtë Marrëveshje (duke përfshirë edhe në Hyrje) kanë kuptimet e mëposhtme:

"Dite Pune" do te kete te njejtin kuptim si ne Marreveshjen e Huase.

"Kolaterali" do te thote Kuotat si dhe te gjitha dhe cdo aksion kuote ne kapitalin e kuotave te Shoqerise qe mund te zoterohet ne te ardhmen nga Barredhenesi;

(B) It is a condition precedent of the Facility Agreement that this Agreement is entered into for the purposes of establishing a security in the form of a Securing Charge (as defined below), over the Collateral (as defined below) by DUFERCO ENERGIA S.P.A, as the Chargor, in favor of the Chargee, which is the at the same time the Lender.

(C) In order to secure the existing and future obligations that the Borrower has or might have towards the Lender (which herein are in quality of Chargee) pursuant to the Facility Agreement, the Chargor has agreed, inter alia, to enter into this Agreement, in order to secure the performance of the Secured Obligations (as defined below) of the Borrower towards the Lender (herein the Chargee) by charging and registering a securing charge over the shares currently owned or that may be owned in the future by the Chargor in the Borrower 'DUFERCO POBREG'SH.P.K with NUIS M11518006H representing the 100%(one hundred percent) of the share capital of the Borrower'DUFERCO POBREG'SH.P.K with NUIS M11518006H and at any value or percentage it may represent in the future.

BASED ON THE ABOVE, the Parties, intending to be legally bound, hereby covenant and agree as follows:

1. DEFINITIONS

1.1 Definitions

Wherever used in this Agreement (including in the Recitals), the following terms shall have the meanings defined herein:

"Business Day" shall have the same meaning provided for in the Facility Agreement

"Collateral" means the Shares and all and any other share in the share capital of the Company which may be owned in the future by the Chargor.



Handwritten signature or mark in blue ink.

Handwritten signature or mark in blue ink.

Handwritten signature or mark in blue ink.

“Vendosja” dhe/ose **“Kompletimi”** (është përkatësisht vendosja, krijimi, kompletimi dhe përmbushja e Barrës Siguruese (ose i çdo ndryshimi apo shtese të saj) mbi Kolateralin, në përputhje me këtë Marrëveshje përmes:

(a) regjistrimit të Barrës Siguruese në: (A) në Regjistrin e Barreve Siguruese (RBS); (B) në regjistrin e brendshëm të kuotave të Shoqërisë

(b) lëshimit të konfirmimit të regjistrimit dhe certifikatës përkatëse nga RBS-ja, që vërteton dhënien (ose ndryshimin apo shtimin) dhe regjistrimin e Barrës Siguruese objekt të kësaj Marrëveshjeje; dhe

(c) regjistrimit të Marrëveshjes Siguruese në QKB

“Establishment” and/or **“Perfection”** each means the establishment, creation and perfection of the Securing Charge (or any amendment or supplement thereof) over the Collateral in accordance with this Agreement by way of:

(a) registration of the Securing Charge with: (A) the Securing Charge Register (RBS); (B) the Company's internal share registry;

(b) procurement of the issuance of a confirmation of registration and respective certificate from the RBS, certifying the granting (or amendment or supplement) and due registration of the Securing Charge granted hereunder; and

(c) registration of the Securing Charge Agreement with the QKB,

“Marrëveshja e Huasë” ka kuptimin që i është dhënë në pikën (A) me sipër tek hyrja më sipër;

“Ligji për Barrët Siguruese” është Ligji Nr. 8537, datë 18.10.1999 “Për Barrët Siguruese”, ndryshuar herë pas here.

“Barrë” është çdo peng, barre, detyrim pagese, privilegj apo përparësi (përveçse kur lind nga ligjet e detyrueshme), garanci, transferim, konfiskim apo çdo barre apo te drejte tjetër të çfarëdo lloji, ose çdo marrëveshje apo rregullim tjetër që ka si efekt vendosjen e nje barre mbi ose në lidhje me, apo ndarjen ose rregullime të tjera preferenciale lidhur me Kolateralin;

“Rast Ekzekutimi” është ndodhja e një Rasti Mospermbushje sipas Marrëveshjes së Huasë.

“Rast Mospermbushje” do të ketë kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Huasë.

“RBS” është Regjistri i Barreve Siguruese në Shqipëri i krijuar sipas Ligjit për Barret Siguruese;

“Detyrimet e Siguruara” janë të gjitha detyrimet dhe përgjegjësitë e tashme dhe të ardhshme në momentin që bëhen të shlyeshme, që i përkasin ose që lindin mbi Huamarrësin

“Facility Agreement” has the meaning ascribed to this term in points (A) at recitals above;

“Law on Securing Charge” means Law No. 8537 dated 18.10.1999, named “Law on Securing Charges” as amended from time to time.

“Lien” means any pledge, charge, privilege or priority (unless arising by virtue of mandatory laws), encumbrance, assignment, attachment or other security interest or right of any kind or any other agreement or arrangement having the effect of conferring security upon or with respect to, or any segregation of or other preferential arrangement with respect to the Collateral;

“Enforcement Event” means the occurrence of an Event of Default as per the Facility Agreement;

“Event of Default” has the meaning as provided in the Facility Agreement

“RBS” means the Albanian Securing Charge Register established as per the Law on Securing Charges;

“Secured Obligations” means all present and future obligations and liabilities at any time due, owing or incurred by the Borrower towards the Lender under the Facility

gjk

M

gjk

kundrejt Huadhënësit në kuadrin e Marrëveshjes së Huasë, si faktike, ashtu edhe kontigjente, dhe nëse janë shkaktuar veçmas apo bashkërisht, dhe si principal ose garanci, apo në çdo kapacitet tjetër, së bashku me të gjitha kostot, detyrimet e pagesës dhe shpenzimet e shkaktuara Huadhenesit lidhur me mbrojtjen, ruajtjen apo ushtrimin e të drejtave të tyre përkatëse në kuadrin e Marrëveshjes së Huasë, apo çdo dokumenti tjetër që i vërteton ose i siguron këto përgjegjësi.

“Periudha e Sigurisë” është periudha që fillon nga data e lidhjes së kësaj Marrëveshjeje e përfundon në ditën kur i gjithë dhe cdo Detyrim i Siguruar është shlyer plotësisht dhe në mënyrë të pakushtezuar dhe të pakthyeshme.

“Barra Siguruese” është e drejta reale e Barremarresit, e ushtruar bashkërisht ose veç e veç, mbi Kolateralin, si të tashëm, ashtu dhe të ardhshëm, në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi, e vendosur dhe kompletuar në përputhje me këtë Marrëveshje, e cila shërben gjatë Periudhës së Sigurisë si garanci për Detyrimet e Siguruara.

“KUOTA” janë 1 (nje)kuote e regjistruar, me vlerë kapitali 250,000 leke (dyqind e pesëdhjetë mijë leke) që përfaqësojnë 100% të kapitalit të **“DUFERCO POBREG” SH.P.K.** nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me seli ne adresen Rruga "Sami Frasheri", Pallati Perxholla nr.1, Shkalla 1, Kati 2, Tirane, Shqiperi, regjistruar si person juridik shqiptar ne Qendren Kombetare te Biznesit me NIPT me Nr. Identifikimi M11518006H ne daten 18/03/2021, (pervecse referuar si **“Huamarresi”**, me tej referuar edhe si **“Shoqeria”**, te dyja termat ne këtë Marrëveshje mund te nderkembehen), te zotëruara nga Barredhenesi, siç përcaktohet në ekstraktin e QKB-së, bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje. **“QKB”** është Qendra Kombëtare e Biznesit në Shqipëri.

1.2. Interpretimi

Në këtë Marrëveshje:

(a) çdo Palë interpretohet në mënyrë të tillë që të përfshijë edhe pasardhësit në titull, cesionarët e lejuar dhe marresit e lejuar te te drejtave.

Agreement, both actual and contingent and whether incurred solely or jointly and as principal or surety or in any other capacity, together with all costs, charges and expenses incurred by the Lender in connection with the protection, preservation or enforcement of its respective rights under the Facility Agreement or any other document evidencing or securing such liabilities

“Security Period” means the period beginning on the date of this Agreement and ending on the day on which all and any Secured Obligations have been unconditionally and irrevocably discharged in full.

“Securing Charge” is the right of the Chargee, exercised jointly or separately, over the Collateral, present or future, in accordance with applicable laws and regulations, Established and Perfected in accordance with this Agreement, and during the Security Period shall serve as a security for the Secured Obligations.

“Shares” mean one registered (share) with a capital value of 250,000 ALL (two hundred and fifty thousand albanian lek), representing 100% of the capital of the **“DUFERCO POBREG” SH.P.K.**, a limited liability company with registered seat at the address, Street "Sami Frasheri", Pallati Perxholla nr.1, Shkalla 1, Kati 2, Tirane, Albania, registered as Albanian legal person at the National Registration Centre with NUIS ID No. M11518006H on 18/03/2021 (in addition to being referred as the **“Borrower”**, hereafter referred to also as the **“Company”**, both terms in this Agreement being interchangeable), owned by the Chargor, as specified according to the QKB extract attached to this Agreement. **“QKB”** means the National Business Center of Albania (Qendra Kombetare e Biznesit in Albanian).

1.2. Interpretation

In this Agreement:

(a) each Party shall be construed so as to include its successors in title, permitted assigns and permitted transferees;

(b) përveçse kur kërkohet ndryshe nga konteksti, fjalët që tregojnë njëjësin përfshijnë edhe shumësin dhe anasjelltas; fjalët që tregojnë persona përfshijnë individë, korporata, partneritete dhe persona të tjerë juridikë; dhe referencat ndaj një personi përfshijnë edhe pasardhësit dhe marresit e lejuar të drejtave;

(c) referenca ndaj një marrëveshjeje, duke përfshirë pa kurrfarë kufizimi, Marrëveshjen e Huasë, duhet interpretuar si referencë ndaj asaj marrëveshjeje siç mund të jetë amenduar, ndryshuar, shtuar, rinovuar apo rregulluar herë pas here, duke përfshirë (pa kurrfarë kufizimi) amendamentet, ndryshimet, shtesat, rinovimet dhe rregullimet lidhur me identitetin e Barrëmarrësve dhe/ose natyrën ose shumën e Detyrimeve të Siguruara.

(d) referenca ndaj një ligji, rregulloreje apo statuti interpretohet si referencë ndaj atij ligji, rregulloreje apo statuti, siç mund të jetë amenduar, ndryshuar apo shtuar herë pas here;

(e) kërret janë vendosur vetëm për qëllime referencë dhe nuk ndikojnë në interpretimin e kësaj Marrëveshjeje; dhe

2. DEKLARIMET DHE GARANCITË

2.1. Deklarimet dhe Garancitë

Nga data e lidhjes së kësaj Marrëveshjeje, Barredhenesi deklaron dhe garanton Barrëmarrësin se:

(a) është pronari dhe perfituesi ligjor i Kuotave;

(b) Shoqëria ka një kapital të regjistruar prej dyqind e pesëdhjetë mijë leke (250,000 lek), i ndare në 1 (nje) kuote të regjistruar, që përfaqëson 100% të kapitalit të Shoqërisë;

(c) Kuotat janë pjesë e një kapitali të nenshkruar të ortakut, të regjistruara dhe të paguar; dhe

(d) Nuk ka asnjë Barrë tjetër mbi Kuotat (per të cilet Huadhenesi/Barremarresi nuk janë

(b) unless the context otherwise requires, words denoting the singular include the plural and vice versa, words denoting persons include individuals, corporations, partnerships and other legal persons and references to a person include its successors and permitted assigns;

(c) a reference to an agreement, including, without limitation, the Facility Agreement, shall be construed as a reference to such agreement as it may be amended, varied, supplemented, novated or assigned from time to time including (without limitation) amendments, variations, supplementations, novations or assignments relating to the identity of the Chargees and/or the nature or amount of the Secured Obligations;

(d) a reference to a law, a regulation or a statute shall be construed as a reference to such law, regulation or statute as it may be amended, varied or supplemented from time to time;

(e) the headings are inserted for convenience of reference only and shall not affect the interpretation of this Agreement; and

2. REPRESENTATIONS AND WARRANTIES

2.1. Representations and Warranties

As of the date of this Agreement, the Chargor hereby represents and warrants to the Chargee that:

(a) it is the legal and beneficial owner of the Shares;

(b) the Company has a registered capital two hundred and fifty thousand albanian lek (250,000 ALL) divided in 1 (one) share representing 100% of the capital of the Company;

(c) the Shares are part of a share capital which is fully subscribed, registered and paid-in; and

(d) There is no other Lien over the Shares (on which the Lender/Chargee have not been made

informuar), dhe nuk ka mbetur pezull as regjistrimi i ndonje Barre, dhe as i veprimeve për krijimin, vendosjen apo kompletimin e një Barre të ndërmarrë nga Barredhenesi, ose në dijeni të Barredhenesit, apo të një personi tjetër;

(e) Barra Siguruese e krijuar e Vendosur dhe Kompletuar sipas kësaj Marrëveshje do të regjistrohet si barre siguruese e rradhes e pare;

(f) Ne lidhje me Barren Siguruese:

(i) është krijuar dhe është dhene ne menyre te ligjshme nga Barredhenesi dhe do te Vendoset dhe Kompletohet ne mënyre te vlefshme sipas parashikimeve te kësaj Marrëveshje , dhe te gjitha detyrimet qe rrjedhin prej saj jane te vlefshme dhe detyruese per Barredhenesin;

(ii) është ne perputhje me legjislacionin shqiptar; dhe

(iii) dhenia, krijimi Vendosja dhe Kompletimi i Barres Siguruese dhe dispozitave te kesaj Marreveshjeje nuk shkelin dhe nuk jane ne kundërshtim me ndonje marrëveshje apo siper marrje tjeter ne te cilen Barredhenesi është pale ose ndonje dispozite ligjore, vendim, dekret apo urdher, tjeter te çdo gjykate apo autoriteti publik, akteve te shoqerise apo çdo dokument tjeter themelues te Barredhenesit;

(h) nuk ka asnje padi apo proces gjyqesor aktual apo te mundshem perpara çdo gjykate apo paneli arbitrazhi, ne Republikën e Shqiperise apo jashte saj, ne lidhje me te drejtat e pronesise mbi Kolateralin;

(i) dhenia, krijimi, Vendosja dhe Kompletimi i Barres Siguruese është pjese e objektit statutor te Barredhenesit dhe te gjitha autorizimet e nevojshme statutore ne lidhje me dhenien, krijimin dhe permbushjen e Barres Siguruese jane marre dhe ruajtur ne fuqi dhe zbatim te plote;

(j) Barredhenesi është nje shoqeri e themeluar ne menyrrë te rregullt dhe sipas ligjeve te jurisdiksionit te saj te themelimit dhe ka dhe do te kete ne çdo kohe te drejtat e nevojshme per te hyre ne kete Marreveshje dhe per te permbushur detyrimet e tij sipas kesaj Marreveshjeje;

aware of), nor is the registration of such Lien pending, nor have any actions for the creation, establishment or perfection of a Lien been undertaken by the Chargor or, to the knowledge of the Chargor, by any other person.

(e) The Securing Charge created, Established and Perfected as per this Agreement, shall be registered in the Securing Charges Register as a first rank securing charge over the Collateral.

(f) In respect of the Securing Charge:

(i) it has been validly granted and created by the Chargor and shall be duly and validly Established and Perfected in accordance with the provisions of this Agreement and all the obligations thereunder constitute valid and binding obligations of the Chargor;

(ii) it is in compliance with the Albanian Law; and

(iii) the granting, Establishment and Perfection of the Securing Charge and the provisions contained in this Agreement do not violate and are not in conflict with any other agreement or undertaking to which the Chargor is a party or any provision of law, decision, decree or other order of any court or public authority, corporate document or any of the constitutional documents of the Chargor;

(h) no claims or proceedings are pending or threatened before any court or arbitration panel, in the Republic of Albania or abroad, in connection with the ownership rights over the Collateral;

(i) the granting, creation and completion of the Securing Charge falls within the corporate object of the Chargor and all authorizations necessary in connection with the granting, creation and completion of the Securing Charge have been obtained and maintained in full force and effect;

(j) the Chargor is a company duly incorporated under the laws of the jurisdiction of its incorporation and it has and will at all times have the necessary power to enter into and perform its obligations under this Agreement;

(k) Barredhenesi nuk eshte ne falimentim apo duke kryer procedura per mbyllje te aktivitetit, likuidimit, falimentimit apo ndonje procedure tjeter te ngjashme dhe nuk eshte e parashikueshme ne menyre te arsyeshme qe as nuk do te kaloje ndonje nga procedurat e mesiperme;

(l) Barredhenesi garanton dhe deklaron me tej dhe merr persiper ndaj Barremarresit se garancite e deklarimet e mesiperme do te jene te verteta dhe te sakta pergjate gjithë kohezgjatjes se Marreveshjes, ne lidhje me faktet dhe rrethanat e pranishme here pas here.

2.2. Besueshmëria dhe Saktësia

(a) Barredhenesi i garanton Barrëmarrësve se çdo deklaratë dhe garanci e dhënë në Seksionin 2.1 është e vërtetë dhe e saktë që prej datës së lidhjes së Marrëveshjes dhe që prej datës së Vendosijes dhe Kompletimit të saj dhe se asnjë deklaratë dhe garanci nuk përjashton asnjë çështje që i bën këto deklarata dhe garanci të pavërteta ose keqinformuese nga pikëpamja materiale;

(b) Barredhenesi pranon se Barrëmarrësi e ka lidhur këtë Marrëveshje në mbështetje dhe në besim të plotë me çdo deklaratë dhe garanci.

3. BARRA SIGURUESE DHE DETYRIMET E SIGURUARA

3.1. Vendosija dhe Kompletimi i Barres Siguruese

(a) Për të siguruar pagesën dhe përmbushjen me përpikmëri të plote të Detyrimeve të Siguruara nga Huamarresi, Barredhenesi me këte Marreveshje i jep Barremarresve dhe krijon ne favor te tyre, nje Barrë Siguruese sipas Ligjit për Barrët Siguruese mbi Kolateralin si dhe merr persiper të kompletejo Vendosijen dhe Kompletimin si barre siguruese të rradhes se pare mbi Kolateral sipas dhe në përputhje me perkufizimin perkates ne klauzolën 1.1 të kësaj Marrëveshjeje.

(b) Barra Siguruese e krijuar e Vendosur dhe Kompletuar sipas kësaj Marrëveshje do te rregjistrohet si barre siguruese e radhes se pare mbi Kolateralin;

(k) the Chargor is not insolvent or undergoing any procedures of winding up, liquidation, bankruptcy or similar procedures and is not reasonably foreseeable to be undergo any foregoing procedures;

(l) the Chargor further represents and warrants to and undertakes with the Chargee that the foregoing representations and warranties will be true and accurate throughout the continuance of this Agreement with reference to the facts and circumstances subsisting from time to time.

2.2. Reliance and Accuracy

(a) The Chargor warrants to the Chargee that each of the respective representations and warranties in Section 2.1 is true and accurate as of the date of this Agreement and as of the date of its Establishment and Perfection and that no representation or warranty omits any matter that makes any of such representations or warranties untrue or materially misleading.

(b) The Chargor acknowledges that the Chargee have entered into this Agreement on the basis of, and in full reliance on, each such representation and warranty.

3. THE SECURING CHARGE AND THE SECURED OBLIGATIONS

3.1. Establishment and Perfection of the Securing Charge

(a) In order to secure the punctual payment and performance of the Secured Obligations by the Borrower, the Chargor, hereby creates a Securing Charge under the Law on Securing Charge with respect to the Collateral in favor of the Chargee and undertakes to complete its Establishment and Perfection as a first ranking security interest over the Collateral pursuant to and in accordance with the related definition in clause 1.1 of this Agreement.

(b) The Securing Charge as created and Established and Perfected as per this Agreement, shall be registered a first rank securing charge over the Collateral;

(c) Kolaterali do të shërbejë si Barre Siguruese e radhës së parë në favor të Barrëmarrësit përgjatë gjithë Periudhës së Sigurisë.

(d) Barredhenesi ka detyrimin për të ndërmarre të gjitha veprimet për Vendosjen dhe Kompletimin e Barres Siguruese mbi Kolateralin. Ky detyrim shtrihet edhe në lidhje me ndryshimet, zëvendësimin, rritjen, shtimin, zvogelimin, heqjen nga Kolaterali që mund të dakordsohet midis Paleve here pas here si dhe të siguroje vazhdimësinë e Barres Siguruese dhe të Kolateralit.

(e) Palet këtu bien dakort që Barremarresi ka gjithashtu të drejtën (por jo detyrimin) të ndermarrin çdo veprim të nevojshëm të parashikuar në, dhe për qëllimin e, paragrafit (d) më lart, të Vendosin dhe Kompletjnë si dhe mbrojnë dhe të ruajnë Kolateralin si dhe të perfitojnë nga Barra Siguruese.

(f) Pa cenuar paragrafët (d) dhe (e) më lart, Barredhenesi në mënyrë të përvokueshme angazhohet që të nënshkruajë, dergojë, regjistrojë dhe depozitojë çdo dokument në mënyrë të krenaqeshme për Barremarresin për qëllimet e paragrafëve (d) dhe (e) më lart, dhe Barremarresi ka të drejtë të marrë nga Barredhenesi kopjet origjinale të nënshkruara rregullisht, bashkë me çdo dokument, depozitim, njoftim, regjistrim, noterizim ose prove tjetër që duhet, sipas opinionit të Barremarresve, për Vendosjen dhe Kompletimin, për vlefshmërinë dhe rradhen e preferimit të Barres Siguruese.

(g) Deri në ndodhjen e një Rasti Ekzekutimi, Barredhenesi do të ketë të drejtën të mbaje posedimin mbi Kolateralin si dhe të ushtroje të drejtën e votës që i njeh zotërimi i Kuotave. Barredhenesi nuk mund të disponojë Kolateralin, pa miratimin paraprak të Barremarresit.

3.2. Koha e zbatimit të të drejtave të Barremarresit

(a) Barra Siguruese dhe të gjitha të drejtat e Barremarresite krijuara në këtë Marrëveshje do t'i bashkëngjiten në këtë datë çdo Kolaterali të

(c) The Collateral shall continuously serve as a first ranking Securing Charge in favour of the Chargee during the Security Period.

(d) The Chargor shall have the duty to undertake all the necessary actions for the Establishment and Perfection of the Securing Charge over the Collateral. Such duty is extended also with regard to any amendment, replacement, increase, addition, decrease, removal of the Collateral that might be agreed which will be agreed by the Parties from time to time as well as to ensure the continuity of the Securing Charge and of the Collateral.

(e) The Parties hereby agree that the Chargee too, are entitled (but not obliged) to undertake any necessary action foreseen and for the purpose of paragraph (d) above, to Establish and Perfect as well as to protect and preserve the Collateral, and to benefit upon the Securing Charge

(f) Without prejudice to paragraph (d) and (e) above, the Chargor hereby irrevocably undertakes to execute, deliver, register and file any document in a manner satisfactory to the Chargee for the purpose of all actions as per (d) and (e) above, and the Chargee shall have the right to receive from the Chargor the duly executed originals, together with any document, recording, filing, notification, registration, notarisation or other evidence required, in the opinion of the Chargee, for the Establishment and Perfection, the validity and priority of the Securing Charge.

(g) Until the occurrence of an Enforcement Event, the Chargor shall have the right to keep possession over the Collateral and shall exercise the voting rights to which the ownership over the Shares does entitle. The Chargor may not dispose of the assets without the prior written consent of the Chargee.

3.2. Effective time of Chargees' rights

(a) The Securing Charge and all the Chargee's rights created hereunder shall attach on the date hereof upon any Collateral owned by the

zoteruar nga Barredhenesi dhe menjehere dhe automatikisht pasi Barredhenesi te jete bere zoterues i çdo Kolaterali te pervetesuar prej tij, pas dates se kesaj Marreveshje. Per aq sa do te jete e nevojshme, me kerkesen e arsyeshme te Barremarresi, Barredhenesi do te nenshkruaje menjehere çdo marreveshje per barret siguroese, sipas formatit te kesaj Marreveshje, si dhe çdo dokument tjetër apo do te kryeje çdo veprim tjetër qe mund te jete i nevojshem me qellim vendosjen e çdo apo te gjithë asetëve përbërëse te ardhshme te Kolateralit te zoteruara nga Barredhenesi pergjate kohezgjatjes se Periudhes se Siguruar, si barre ne favor te Barremarresit.

(b) Të gjitha të drejtat e Barrëmarrësit të parashtruara këtu janë të parevokueshme pergjate gjithë Periudhës së Sigurisë.

3.3 Detyrimet e Siguruara sipas Marreveshjes

(a) Kjo Marreveshje ka per qellim te siguroje, dhe siguron, pagesen e plote e te gjithanshme te Detyrimeve te Siguruara

(b) Barra Siguroese, jepet si barre e shkalles se pare gjate gjithë kohëzgjatjes se Periudhes se Siguruar dhe do te renditet përpara cdo te drejte tjetër te palëve te treta.

(c) Barra Siguroese nuk do te reduktohet ne asnjë menyre per arsye te ndonje shlyerje te pjesshme te Detyrimeve te Siguruara.

(d) Barra Siguroese do te kete fuqi te plote pavaresisht dispozitave te ndonje garancie apo Barre tjetër, qe mund te kete qene ose mund t'i jepet ne çdo menyre dhe nga çdo person, Barremarresit.

(e) Pa cenuar detyrimet e Barredhenesit per te përdorur Kolateralin, Barra Siguroese nuk do te çlirohet ose te zvogelohet ose afektohet ne çdo menyre tjetër nga:

(i) marrja me, ekzistenca e, ose vlefshmeria e, ndonje Barre tjetër te marre nga Barremarresi sipas Marreveshjes se Huase;

(ii) pervec se kur parashikohet nga legjislacioni Shqiptar, çdo amendament, ndryshim, ose

Chargor and immediately and automatically upon the Chargor becoming owner of any Collateral acquired after the date hereof. To the extent necessary, upon the reasonable request of the Chargee, the Chargor shall promptly execute an agreement of securing charge substantially in the form of this Agreement and any other document, and take any other action, which may be necessary in order for any and all the future composing asset of the Collateral owned by the Chargor during the Security Period to be charged in favor of the Chargee.

(b) Subject to the limitations herein, all rights of the Chargee under this Agreement are irrevocable during the Security Period.

3.3 Obligations Secured under the Agreement

(a) This Agreement is made in order to secure, and secures, the payment in full of all the Secured Obligations.

(b) The Securing Charge, is granted as first ranking security for the entire duration of the Security Period and shall thus rank ahead of any other encumbrance or third party right.

(c) The Securing Charge shall not be reduced in any way by reason of any intermediate payment or partial settlement of the Secured Obligations;

(d) The Securing Charge shall have full effect regardless of the provision of any other guarantee or Lien that might have been or might be furnished in any way or respect and by any person to the Chargee.

(e) Without prejudice to the obligation of the Chargor not to dispose in any manner of the Collateral, the Securing Charge shall not be discharged, impaired or otherwise affected in any way by:

(i) the dealing with, existence or validity of any other Lien taken by the Chargee under the Facility Agreement;

(ii) subject to mandatory provisions of Albanian law, any variation, extension,

shtese, heqje dore, kompromis apo çlirim i cdo Detyrimi te Siguruar, apo çdo ndryshim ne ligj, rregulla apo rregullore te cdo juridiksioni, apo çdo veprim i ndonjë autoriteti apo gjykate qe ndryshon, pakëson apo e afekton ne çdo menyre tjetër ose qe ka per qellim te ndryshoje, pakesoje apo afektoje ne çfarëdolloj menyre tjetër secilën nga Detyrimet e Siguruara;

